



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9/2020 (JR)
Nr. 9/4 regj.

Tiranë, më 10.12.2020

SHPALLJE
E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 10.12.2020, ora 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 9/2020, datë 13.02.2020 për ankimin e subjektit të rivlerësimit Agim Bendo kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 216, datë 04.12.2019, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ditën e martë, në datën **22.12.2020**, ora **10.00**, për t’i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit Agim Bendo të dëgjohet lidhur me çështjen e tij.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuesi i Trupit Gjykses
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Ardian Hajdari
Natasha Mulaj
Albana Shtylla
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit.

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR

ARDIAN HAJDARI

